REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 84/17
Datë/Datum 24.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***KUVENDI KOMUNAL GRA□ANICËS***

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: ***GRA-160-79-221***

Sa i përket tenderit për : ***Hartimi i projekteve- Dokumentacioni teknike për nevojat e Komunvës së Gra□anicës***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

STUDIO HAPSIRA SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

MAT 1- PRISHTINË
(Adresa)

PRISHTINË — *100000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/150-123 — /
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

BESART HALIMI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
studiohapsira@gmail.com
(Adresa elektronike)

24.03.2016
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Studio Hapsira

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

_____/_____

(Adresa e plotë)

_____/_____ _____/_____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____/_____

(Adresa elektronike)

_____/_____ _____/_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Më datën 05.01.2017 është publikuar njoftimi për kontratë.*
- *Afati i dorëzimit ofertave ,data 23.010.2017 koha 14.00:00 vendi Rr : Rruga , Car Lazar , nr . 131 , Ndërtesa e re e Komunës afër Stacionit të Policisë , Gra□anicë*
- *Hapja e ofertave po të njëjtën datë : data 23.010.2017 koha 14.30:00 vendi Rr : Rruga , Car Lazar , nr . 131 , Ndërtesa e re e Komunës afër Stacionit të Policisë , Gra□anicë*
- *Për letrës standarde për tenderuesin e eleminuar jemi njoftuar më datën : 10.03.2017- formulari B42.*
- *Më datën 10.03.2017 përmes formularit B08 – Është bërë njoftimi për dhënie të kontratës përmes e-prokurimit.*
- *Më datën : 15.03.2017 përmes formularit F02 – Kemi bërë Kërkesën për Ri-shqyrtim të lëndës pran AK .*
- *Më datën 16.03.2017 : AK ka rishqyrtuar lëndën tonë dhe ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim të lëndës.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Hapja e ofertave po të njëjtën datë : data 23.010.2017 koha 14.30:00 vendi Rr : Rruga , Car Lazar , nr . 131 , Ndërtesa e re e Komunës afër Stacionit të Policisë , Gra□anicë , nuk ka pasur vërejtje .

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Përmes letrëa standarde për tenderuesin e eleminuar jemi njoftuar me datën : 26.01.2017 – Formulari B42 ,

Arsyetim :

I/e nderuar(a)
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj *nuk qe tenderi me çmimin më të ulët* në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë së kontrata i është dhen OE, ENG GROUP – Prishtinë: në vlerë prej 17,006.60 €

Më datën 15.03.2017 kemi kërkuar qajse zyrtare pranë Autoriteti Kontraktues dhe kemi marrë dokumente e nevojshme për rishqyrtim të cilat janë :

1. **Qarkulllimin Bnakar**
2. **Listën e ingjinerve të angazhuar të bashkangjitura me cv dhe diploma.**
3. **Qertifikatën ISO**
4. **Refrencat e pervojës së punës së ingjinierve .**
5. **Paramasën dhe parallogarinë.**

Gjatë analizës dhe vlerësimit të dokumentacionit konstatimet tona jane në vijim :

Të gjitha kontrata e stafit të angazhuar në këtë projet janë të skaduara të vitit 2013 , edhe pse në emërtim janë emërtuar **" Kontrata pune për kohë të pacaktuar "** , në përmbajtjen e kontratës janë pëfshirë kushte , **kritere dhe nene të një kontrate për themelimin e një mardhënie pune për kohë të caktuar** e cila bjen ndeshë me LIGJIN E PUNËS 03/L-212.

Për inxhinierin e makinerisë **Halim Halimi** ka përcaktuar pagën minimale e cila është në kundërshtim me : UDHZIMIN ADMINISTRATIV (MPMS) NR. 09/ 20I3 PER KRITERET DHE PROCEDURAT E PERCAKTIMIT TË PAGËS MINIMALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.

Në këtë rast AK kur kontratat janë më të vjetra se 3 vjetë është dashur ti verifikoj me sqarime plotësuese se këta punëtor a janë ende në mardhënie pune në kompaninë në fjalë apo janë prezentuar kontrata mashtruese , në këtë rast verefikimi bëhet përmes pagesave të trusti penzional.

Me vendim të kompanisë Enggroup është caktuar Menaxheri i Projektit : z. **Kreshnik Shehu ,** në dokumentet të cilat na janë prezantuar :

Mungojnë 3 refrenca për projektet e ngjashme të menaxherit projektit ashtu siq është kërkuar : KUSHTET E PËRSHTATSHMËRISË , NENI III.2.4- KAPACITETI TEKNIKE DHE PROFESIONAL- I njoftimit për kontratë dhe dosjes tenderit.

Në këtë rast O.E ENGGROUP për menaxherin e caktuar me vendim ka prezantuar dy refrenca jo tri ashtu siq është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Referenca e datës 25.03.2016 dhe referenca e datës 20.09.2016

P.S Më këtë rast drejtori i O.E në fjalë në cilësin e menaxherit projketit i ka bërë refrencë vetë vetës brenda kompanisë , andaj i konsiderojmë këto referenca subjektive, nuk ka palë të dyta apo kompani bashkpuntore e cila mund të vlersoj aftësit profesionale dhe vlerësimin e përformancës të palës bashkëpunuese.

Më datën 16. 03.2017 AK ka marrë vendimin për refuzimin e kërkesës tonë i cili është në vijim :

VENDIM

Autoriteti Kontraktues Komuna Graqanicës – Zyra e Prokurimit duke u bazuar në nenin 5 Kalkulimin e afateve kohore pika 1 dhe 2 të këtij Neni dhe në bazë të Nenit 108/A zgjidhja preleminare e mosmarëveshjeve pika 3.2 dhe pikën 8.1 të kvtij neni të LPP-së , refuzon : **SI TË PA AFATSHME**- Kërkesën për Rishqyrtim –Akesën , e konzorciumit Studio Hapsira – Prishtinë & Geomap –Viti , kundër njoftimit pë dhënie të kontratës për projektin : Hartimi i Projekteve – Dokumentacionit Teknike për nevojat e Komunës së Graqanicë " me numër prokurimit · GRA-618/16/079/221 , të publikuar me datën 10.03.2017.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

NENI 108/A zgjidhja preleminare e mosëmarrëveshjeve pika 3.2 të LPP
NENI 7 : Barazia në trajtim / jo-diskriminimi.
NENI 10 : Mjetet për promovimin e transparencë.
NENI 24 : Zyrtaret e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit.
NENI 27 : Dosja e tenderit.
NENI 28 : Llojet e specifikimeve teknike.
NENI 40 : Njoftimi i kontratës.
NENI 51 : Njoftimi i kritereve të dhënies kontratës.
NENI 56 : Dizpozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave .
NENI 59 : Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
NENI 60 : Kriteret për dhënien e kontratës .
NENI 64 : Dëshmi Kërkesa.
NENI 67 : Provat shkresore .
NENI 69 : Aftëssia teknike dhe /ose profesionale.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Bazuar në **Ligji Nr. 04/L-042, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

Nenit 108/A zgjidhja preleminare e mosmarëveshjeve pika 3.2 të kvtij neni të LPP-së Rregullat për parashtrim të ankesës – Formulari F03 , Neni 4 paragrafi (b).

- Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te nje konkursi te projektimit brenda afatit prej **pesë (5) ditëve** pas **datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.**

Ne Jemi njoftuar përmes Letrës standarde për tenderuesin e eleminuar më datën 10.03.2017 , Më datën **15.03.2017** kemi bërë kërkesën për Ri-shqyrtim të lëndës-Ankesës. Më datën 16.01.2017 kërkesa jonë është refuzuar si e – PA AFATSHME

Në këtë rast AK ka bërë shkelje serioze të LPP , pasi Kërkesa jonë për rishqyrtim të lëndës nuk e ka tejkaluar afatin prej 5 ditëve ashtu siq është përcaktuar në LPP në dispozitat e cekura më lartë

- *Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kulifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit të kontratës . Gjatë vendosjes së kësaj kërkese , autoriteti kontraktues mund të kërkoj nga operatorët ekonomik që të sigurojnë , nëse është relevante dhe e nevojshme , njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në kriteret teknike dhe procedurave që shpien drejtë dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet leferimi produketeve /shërbimeve , nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësin e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim , sipas llojit, sasisë dhe qellimit të produktit/shërbimeve që furnizohen*

- *Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatatë e kërkuara janë vendosur dhe përshkruar në këtë NEN, duhet të jenë drejtëpërdrejtë relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse*

- Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit , të gjitha Autoritet Kontraktuese do të sigurojnë *(i) pjesëmarrjen me të gjërë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimi i rregullt, dërgimi dhe /ose disponueshmëria e gjitha njoftimeve, ftesave , informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj ; (iii) eleminimin e praktikave, kritereve , kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë*

operatorëve ekonomik ; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie , duke përfshire rëndësin relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë; (v) që asnjë kërkesë , specifikim që nuk është saktësuar kështu të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhëbie ; ***(vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektët përmbajtësore të kushteve ,kritereve dhe specifikimeve teknike.***

PËRFUNDIM : Konsiderojmë që kompania fituese e kontratës ENGGROUP , nuk i plotëson KUSHTET E PËRSHTATSHMËRISË , NENI III.2.4 – KAPACITETI TEKNIK DHE PROFESIONAL – I njoftimit për kontratë dhe dosjes tenderit.

Duke u bazuar në argumentet e specifikauar më lartë kërkojmë nga AK të bëjë anulimin për dhënie Kontratës , e njëjta ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të marrë si të bazuar kërkesën tonë për ri-shqyrtim të lëndës , pasi konsiderojmë që AK gjatë këtij aktiviteti të prokurimit në masë substanciale nuk e ka rrespektuar LPP

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit kompanisë , një numër i konsiderushëm të punëtorve kanë mbetur pa punë etj.
Vlera e dëmit kap vlerën 100,000.00€

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*